



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo za Financije, Rad i Transfere
Ministry of Finance, Labor and Transfers*

▶ UDHËZUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR FËMIJË NË FORMA TË RREZIKSHME TË PUNËS

MAJ, 2021
PRISHTINË



**▶ UDHËZUES PËR ZBATIMIN E
PROCEDURAVE STANDARDE
TË VEPRIMIT PËR FËMIJË NË
FORMA TË RREZIKSHME TË
PUNËS**

► FALËNDERIME

Ky dokument është pjesë e projektit projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7. Fondet janë mundësuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër IL 30147 16 75 K 11. 100% e të gjitha shpenzimeve të projektit financohen nga fondet federale, në vlerë prej 22,4 million dollarësh, prej të cilave \$162,000 janë alokuar për aktivitetet në Kosovë.

► NJOFTIM:

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

► TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E AKRONIMEVE	7
PARATHËNIE	8
PËRMBLEDHJE	9
PËRKUFIZIMET	10
I. PËRKUFIZIMI I PUNËS SË FËMIJËVE	13
II. PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR FËMIJË NË FORMA TË RREZIKSHME TË PUNËS	17
PARIMET E PËRGJITHSHME TË PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT	18
VIZIONI DHE QËLLIMET E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT	19
MONITORIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR FËMIJËT NË PUNË	20
FUNKSIONALIZIMI NË NIVEL LOKAL	22
Hapi 1: Vendosja e institucionit udhëheqës për monitorimin e zbatimit të PSV-ve në nivel komunal	22
Hapi 2: Zhvillimi i procesit të menaxhimit të rastit	23
Hapi 3: Zhvillimi i mjeteve/instrumenteve të nevojshme për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve në punë, planifikimin e masave të nevojshme dhe raportimin e rregullt mbi situatën, arritjet dhe sfidat në adresimin e punës së fëmijëve	23
Hapi 4: Zhvillimi i modelit për monitorimin e zbatimit të PSV-ve	24
Hapi 5: Zhvillimi i një komunikimi të mirëfilltë ndër-sistemik.	24
HAPAT E ZBATIMIT TË MENAXHIMIT TË RASTIT DHE MASAVE TË PSV-VE	25
HAPI 1: Parandalimi	25
HAPI 2: Identifikimi dhe referimi	26
Hapi 3: Vlerësimi i rastit (fillestar dhe gjithëpërfshirës)	27
Hapi 4: Planifikimi i shërbimeve individuale	28
Hapi 5: Mbrojtja dhe rehabilitimi i fëmijëve	29
Hapi 6: Zbatimi, shqyrtimi dhe monitorimi i rastit	29
Hapi 7: Dokumentimi	29
Hapi 8: Mbyllja e rastit	29
Hapi 8: Përcjellja e rastit	30
Hapi 9: Udhëheqja (menaxhimi) dhe analiza e të dhënave	30
Hapi 10: Shfrytëzimi i të dhënave për fuqizim të zbatimit/përmirësim të ligjeve dhe politikave	30
SHTOJCAT:	31

▶ LISTA E AKRONIMEVE

▶ DKA	Drejtorati Komunal i Arsimit
▶ DKSHMS	Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
▶ DPSF	Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
▶ EDF	Ekipi për të Drejtat e Fëmijës
▶ FRRP	Format e Rrezikshme të Punës
▶ IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
▶ MASHTI	Ministria për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion
▶ MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
▶ MPF	Monitorimi i Punës së Fëmijëve
▶ MR	Menaxhimi i Rastit
▶ MSH	Ministria e Shëndetësisë
▶ OJQ	Organizata Joqeveritare
▶ ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
▶ PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
▶ QPS	Qendra për Punë Sociale
▶ UA	Udhëzim Administrativ

► PARATHËNIE

Në qershor të vitit 2020, në Republikën e Kosovës hyri në fuqi Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ligj ky që në mes tjerash ka për qëllim të mbrojë fëmijët nga të gjitha format e keqpërdorimit, shfrytëzimin apo formave tjera që vënë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Kapitulli i katërt në këtë ligj në mënyrë specifike adreson mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, ku ndalon punësimin e fëmijës në aktivitete që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, dhe e mandaton Inspektoratin e Punës si përgjegjës për monitorimin e punësimit të fëmijës për të garantuar mirësjelljen, sigurinë dhe kushtet e punës.

Duke pasur këto parasysh dhe bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, nevojitet me urgjencë që të bëhet monitorimi i punës së fëmijëve, që është në pajtim edhe me nenin 5 të Konventës së ONP-së nr. 182, për të shërbyer si bazë për formalizimin e procedurave standarde të veprimit për:

- identifikimin, tërheqjen, mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga rruga;
- dokumentimin e trendeve të punës së fëmijëve në sektorë specifikë;
- vlerësimin e efikasitetit të ndërhyrjeve ekzistuese në nivel lokal, duke përfshirë rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve konkrete të veprimit dhe referimin e rasteve në Prokurori dhe Gjykata.

Rrjedhimisht, janë zhvilluar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të cilat përcaktojnë dhe qartësojnë rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës; dhe synojnë të përforcojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për të mbrojtur fëmijët nga format e rrezikshme të punës (FRRP).

Dokumenti i PSV-ve është zhvilluar bazuar në Profilin e Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Kosovë (2007) dhe pas hyrjes në fuqi e shfuqizon/zëvendëson, duke iu referuar kuadrit të ri ligjor dhe procedurave për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë¹. Poashtu, cdo ndryshim i referencave bazë mbi të cilat është ndërtuar ky dokument, reflektohet edhe në këtë dokument.

PSV-të synojnë të kontribuojnë në përfshirjen e çështjeve të punës së fëmijëve në sistemet e qeverisjes lokale duke institucionalizuar procesin e identifikimit dhe largimit të fëmijëve nga format më të këqija të punës së fëmijëve. Në këtë kuptim, PSV-të shërbejnë gjithashtu si një mekanizëm për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzim Administrativ QRK nr. 05/2013 për parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve nr. 06/L-084, neni 20, secila Komunë, në nivel të vendimarrjes politike, krijon Ekipin për të Drejtat e Fëmijës (EDF), përgjegjës ndër të tjera për zhvillimin e programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në fenomene të mundshme negative dhe ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët. EDF-të janë përgjegjëse edhe më zbatimin e PSV-ve në komunat përkatëse.

¹ Monitorimi i Punës së Fëmijëve (MPF) është vërtetuar të jetë efektiv në adresimin e punës së fëmijëve, veçanërisht në adresimin e punës së fëmijëve në sektorin joformal, ku edhe frekuenca e punës së fëmijëve në vendin tonë duket të jetë më e madhe.

► PËRMBLEDHJE

Ky udhëzues është përgatitur nga Blerta Perolli Shehu, në kuadër të projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7, financuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së.

Udhëzuesi është ndërtuar mbi udhëzuesin e përgatitur nga MA Edona Berisha- Kida, në kuadër të mbështetjes së ILO IPEC për shtrirjen dhe funksionalizimin e sistemit të monitorimit të punës së fëmijëve në Kosovë gjatë vitit 2011.

Në pjesën e parë të materialit janë dhënë përkufizimet e koncepteve themelore që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve.

Kapitulli 1 përshkruan vizionin dhe qëllimet kryesore të PSV-ve, si dhe parimet që mbështesin këto PSV.

Kapitulli 2 ofron udhëzime dhe rekomandime për zbatimin e PSV-ve në nivel komunal dhe funksionalizimin e sistemit të monitorimit të zbatimit të PSV-ve. Udhëzimet iu adresohen Ekipeve për të Drejtat e Fëmijëve në nivel komuna.

Ky kapitull bën edhe një përmbledhje të hapave të menaxhimit të rastit dhe zbatimit të PSV-ve për të institucionet që vijnë në kontakt me fëmijët në punë.

Shtojcat ofrojnë informata dhe instrumente shtesë për strukturat lokale mbi PSV-të, përfshirë:

- Shtojca 1: Forma për raportimin e situatës së punës së fëmijëve në nivel komunal
- Shtojca 2: Forma për planifikimin dhe raportimin mbi zbatimin e Planit Komunal të Veprimit
- Shtojca 3: Forma e raportimit vjetor mbi punën e fëmijëve

► PËRKUFIZIMET

Fëmijë – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Në rastin kur moshë e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa moshë e tij të jetë përcaktuar plotësisht;

I mitur - nënkupton fëmijën në mes të moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeç;

Prind - nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar, apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë;

Përgjegjësi prindërore – nënkupton obligimin e prindit për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte vetanake me fëmijën dhe obligimin për t'i siguruar fëmijës mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës;

Mbrojtja e fëmijës - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë;

Fëmijë në nevojë për mbrojtje - është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin;

Puna e lejuar për fëmijë - është pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijojnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet;

Puna e ndaluar për fëmijë - është puna apo aktiviteti i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës;

Format e rrezikshme të punës së fëmijës - janë punë që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime (shpeshherë permanente) apo sëmundje (shpeshherë permanente) të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës;

Monitorimi i Punës së Fëmijëve (MPF)- është proces i: identifikimit, vlerësimit, tërheqjes dhe mbrojtjes së fëmijëve nga format e rrezikshme të punës; dokumentimit të vazhdueshëm të trendeve dhe shtrirjes së punës së rrezikshme të fëmijëve; vlerësimit të vazhdueshëm të efektivitetit të politikave dhe masave ekzistuese për tërheqjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës si dhe rekomandimit të masave të nevojshme për zhvillim/avansim të vazhdueshëm të politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes bazuar në të dhëna faktike;

Ekipi- nënkupton Ekipin për të Drejtat e Fëmijës;

Përfaqësues ligjor- nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësisë që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;

Dhunë ndaj fëmijës – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual;

Neglizhimi i fëmijës - nënkupton mosveprimin me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës;

Parandalimi - nënkupton një sërë masash të përbashkëta të ndërhyrjes së hershme edukative, arsimore, sociale dhe ligjore në favor të fëmijës dhe familjes, që është i kërcënuar apo në rrezik në zhvillimin e tij, në mënyrë për t'i rivendosur

kushtet për zhvillimin e tij, për t'i parandaluar akte e keqtrajtimit apo për të parandaluar përsëritjen e tyre duke mundësuar rivendosjen e kompetencave prindërore-rehabilitimin e kompetencave prindërore;

Mbrojtja e fëmijës - nënkupton aktivitetet që ndërmerren për t'i mbrojtur fëmijët që janë duke vuajtur, ose ka të ngjarë të vuajnë nga një rrezik serioz, si dhe çdo veprim që siguron fëmijën të jetojë në një familje apo mjedis tjetër të sigurt, ku mbrohet jeta dhe shëndeti dhe respektohen të drejtat e tij, ku sigurohet edukimi, arsimit dhe zhvillimi, duke i mbrojtur ata nga çfarëdo lloj dhune, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, keqtrajtimi, eksploatimi, lënie pas dore, abuzimi dhe shfrytëzimi, në çdo kontekst, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijës dhe praktikën e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjinitale, martesë e fëmijës dhe abuzimi;

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve - nënkupton çdo shërbim për ofrimin e kujdesit social ose psikosocial, ndihmës juridike, përfaqësimit ligjor, kujdesit shëndetësor, ndihmës ar- 11 simore dhe kulturore ose, në rrethana të jashtëzakonshme, ndihmës materiale për fëmijën në nevojë;

Tryeza Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit - nënkupton grupin multidisiplinar, që përfshinë profesionistët nga institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe akterët e tjerë që përfaqësojnë një shumëllojshmëri të disiplinave, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, ndërveprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për të trajtuar rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore të tyre në bazë të interesit më të mirë të fëmijës. Fëmija dhe familja mund të jenë pjesëmarrës në tryeza;

Menaxher i rastit - nënkupton zyrtarin përgjegjës i caktuar nga Organi i Kujdestarisë për menaxhimin e rastit të fëmijës, i cili, në bashkëpunim me akterët relevantë, vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes;

Qendra për Punë Sociale (QPS) - nënkupton institucionin publik profesional, të nivelit komunal, kompetent edhe për mbrojtjen e fëmijës në nevojë;

Organi i Kujdestarisë- është organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale në kuadër të Qendrave për Punë Sociale (QPS). Përbëhet nga një grup i ekspertëve me përvojë profesionale në fushën e veçantë të përgjegjësisë dhe prioritet ka mirëqenien dhe interesin më të mirë të fëmijës. Organi i Kujdestarisë pjesëmarrës në procedurë është i autorizuar të bëjë propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve, të paraqesë fakte të cilat nuk janë përfshirë, të propozojë administrimin e provave të domosdoshme, të ushtrojë mjetet juridike dhe të ndërmarrë veprime të tjera gjyqësore;

Institucion - nënkupton të gjitha institucionet publike, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe personat e tjerë juridikë e privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës në këtë Ligj dhe legjisllacionin në fuqi;

Sistemi për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton strukturën e caktuar formale dhe jo formale, me funksionet dhe kapacitetet e përmbledhura dhe të bashkuara për të parandaluar dhe reaguar dhunën, abuzimin, neglizhimin dhe shfrytëzimin e fëmijës. Sipas kuptimit të përgjithshëm, sistemi për mbrojtjen e fëmijës përbëhet nga këto komponente: resurset njerëzore dhe financiare, ligjet dhe politikën, qeverisja, monitorimi dhe mbledhja e të dhënave, shërbimet mbrojtëse dhe reaguese, si dhe menaxhimi i rastit. Sistemi përfshin edhe akterë të ndryshëm, siç janë: fëmijët, familja, komuniteti, shërbyesit dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, duke mos përjashtuar edhe ata në nivel ndërkombëtar. Funksionimi i sistemit varet nga ndërveprimi dhe marrëdhëniet ndërmjet komponentëve dhe akterëve brenda këtij sistemi.

Fëmijë me aftësi të kufizuara- nënkupton fëmijët, të cilët kanë një e më shumë aftësi të kufizuara, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, intelektual dhe psiko/motor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilët e vështirësojnë mbarëvajtjen e jetës së përditshme.

Interesi më i mirë i fëmijës- në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta. Kjo kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës. Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa;

Menaxhi m i rastit- është një mënyrë e organizimit dhe kryerjes së punës për t'i adresuar nevojat individuale të fëmijës (dhe familjes së tij) në mënyrë të përshtatshme, sistematike dhe me kohë, nëpërmjet mbështetjes dhe/ose referimeve të drejtpërdrejta (Global Protection Cluster, 2014);

Referim i rastit- është procesi i të kërkuarit në mënyrë zyrtare të shërbimeve për një fëmijë ose familjen e tij nga një agjenci tjetër përmes një procedure të përcaktuar;


Shprehjet tjera të përdorura në këtë dokument kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

Interesi më i mirë i fëmijës- në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.



01

PËRKUFIZIMI I PUNËS SË FËMIJËVE



Jo të gjitha punët që kryejnë fëmijët dhe adoleshentët duhet të klasifikohen si “punë e fëmijëve”. Kjo varet nga mosha e fëmijës, lloji i punës, orari i punës, kushtet nën të cilat bëhet puna dhe rrezikshmëria për fëmijën. Punët të cilat nuk ndikojnë negativisht në shëndetin dhe zhvillimin personal të fëmijëve, që nuk ndërhyjnë në shkollimin e tyre dhe jetën e tyre fëmijërore sociale, dhe që nuk paraqesin rrezikshmëri për aftësitë psikofizike të fëmijës, konsiderohen që janë përvoja pozitive të angazhimit të fëmijës që kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve dhe në mirëqenien e familjeve të tyre dhe gjithashtu u sigurojnë atyre aftësi dhe përvojë, si dhe i ndihmojnë në përgatitjen e tyre për të qenë anëtarë produktivë të shoqërisë gjatë jetës së tyre si të rritur.

Puna e fëmijëve është punë e cila me natyrën ose mënyrën sesi zhvillohet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon fëmijës të drejtën për arsim. Aspektet kryesore që mund të dëmtojnë fëmijën përfshijnë: a) orët e gjata në punë, b) ngacmimet fizike, morale dhe psikologjike që i shkaktohen fëmijës, c) pamundësia për të ndjekur shkollën dhe për të gëzuar të drejtën për rekreacion. Në të kundërtën, termi **puna e lejuar për fëmijët** përdoret për të përshkruar pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete ekonomike jo të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, dhe veçanërisht që nuk e pengojnë fëmijën që të ndjekë shkollën dhe të luajë.

Në përputhje me Konventën Nr 138 të ILO-s për Moshën Minimale të Punësimit, Ligji i Punës në Kosovë ndalon punën e fëmijëve nën moshën 15 vjeç, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndjekin arsimin e detyruar. Moshë 18 vjeç është përcaktuar për futjen në punësim të rrezikshëm.

Punë e lehtë

Në përputhje me Konventën Nr. 138 të ILO-së për Moshën Minimale të Punësimit, puna e lehtë është përcaktuar në Ligjin e Punës në Kosovë si punë që nuk është e dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, dhe që nuk ndikon në ndjekjen e shkollës.

Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve

Konventa e ILO-së për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve (Konventa 182) u miratua unanimisht nga të gjithë delegatët e ILO-së në vitin 1999 dhe mbulon të gjithë fëmijët derisa mbushin moshën 18 vjeç. Siç sugjeron dhe titulli, kjo Konventë merret me të gjitha format e këqija të punës së fëmijëve që duhet të eliminohen urgjentisht për të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç, pa marrë parasysh nivelin e varfërisë apo të zhvillimit të vendit që ka ratifikuar Konventën.

Neni 3 i kësaj Konvente përcakton format e këqija të punës së fëmijëve:

- a. Të gjitha format e skllavërisë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavërues dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimin pa dëshirë ose i detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;
- b. Përdorimin, gjetjen ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
- c. Përdorimin, gjetjen ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike, sikundër janë përkufizuar në traktatet ndërkombëtare;
- d. Puna, e cila për shkak të natyrës apo rrethanave në të cilat zhvillohet, mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë dhe moralin e fëmijëve.

Kategoria e katër (d) referohet në Konventën 182 si Punë e rrezikshme e Fëmijëve dhe ka të bëjë me punën që mund të rezultojë me vdekje, lëndime (shpesh të përhershme) apo sëmundje (shpesh kronike) si pasojë e standardeve të ulëta të vendit të punës, të sigurisë dhe shëndetit, të kushteve dhe marrëdhënies së punës. Në disa raste, puna e rrezikshme mund të shndërrohet në punë jo të rrezikshme duke përmirësuar kushtet e punës dhe duke shtuar masat mbrojtëse.

Puna e rrezikshme e fëmijëve

Për shkak se ekonomitë, industritë, kushtet dhe proceset e prodhimit ndryshojnë nga vendi në vend, Neni 4 i Konventës së ILO-së Nr. 182 kërkon që çdo vend të përgatis listën e punëve të rrezikshme.

Udhëzimi Administrativ nr. 05/2013 për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë që hyri në fuqi në Korrik 2013 liston sektorët e rrezikshëm dhe aktivitetet e rrezikshme që duhen ndaluar urgjentisht në Republikën e Kosovës.

Aktivitetet e përgjithshme të ndaluara për fëmijët deri në moshën 18 vjeç përfshijnë:

- ▶ Puna e natës, ndërmjet orës 20:00 dhe 06:00;
- ▶ Ngritja dhe bartja e kohëpaskohshme e peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F)
- ▶ Ngritja dhe bartja e vazhdueshme e peshave të rënda mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);
- ▶ Puna që kërkon ekuilibër të veçantë;
- ▶ Puna në thellësi, në sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura;
- ▶ Puna në lartësi mbi 2 m;
- ▶ Puna që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e tyre, për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, apo ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- ▶ Puna që përfshin ekspozim ndaj substancave biologjike, kimike, fizike dhe toksike si dhe ekspozim ndaj radioaktivitetit, ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave;

Sektorët më të rrezikshëm dhe aktivitetet specifike për ndalim të menjëhershëm përfshijnë:

1. Bujqësinë dhe pylltarinë

- ▶ Puna në ujitje,
- ▶ Operimi me makina bujqësore,
- ▶ Puna me pesticide dhe spërkatja,
- ▶ Korrjet,
- ▶ Punë të rënda fizike në fusha dhe hapja e gropave për pyllëzim ose mbjellje të pemëve,
- ▶ Hapja e puseve, kanaleve
- ▶ Prerja e drunjëve dhe përpunimi i drurit,
- ▶ Puna në thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit,
- ▶ Gjuetia/ peshkataria

- ▶ Grumbullimi i frutave malorë dhe vjelja e pemëve,
- ▶ Puna në serrë,
- ▶ Puna në bletishtë

2. Punën në rrugë

- ▶ Bartja e peshave të rënda,
- ▶ Pastrimi i parafangove të automjeteve në komunikacion,
- ▶ Kërkimi i lëmshës,
- ▶ Shitja e gjësendeve ushqimore, duhanit, etj.

3. Punën në ndërtimtari

- ▶ Gërmimi i dheut,
- ▶ Transportimi i peshave të rënda,
- ▶ Sitja e rërës dhe çimentos,
- ▶ Puna në skela,
- ▶ Përpunimi i metaleve.

4. Punën në deponi të mbeturinave

- ▶ Hulumtimi dhe grumbullimi i mbeturinave në deponitë e mbeturinave apo në kontejnerë.
- ▶ Bartja e materialit të grumbulluar në distanca të largëta.


5. Punën në eksploatimin e pasurive natyrore,

- ▶ Gërmimet sipërfaqësore të thëngjillit, rërës dhe gurëve,
- ▶ Eksploatimi i thëngjillit, rërës dhe gurëve



02

PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR FËMIJË NË FORMA TË RREZIKSHME TË PUNËS



► PARIMET E PËRGJITHSHME TË PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT

Qasja e Procedurave Standarde të Veprimit është e bazuar në të drejtat e njeriut dhe është një qasje sensitive për mbrojtjen e fëmijëve, duke synuar interesin më të lartë të tyre. PSV-të marrin në konsideratë në mënyrë specifike detyrimin e posaçëm që ka shteti në lidhje me fëmijët, më konkretisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës bazuar në interesin më të lartë të tij/saj.

Mbijetesa dhe zhvillimi- e drejta e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër.

Mosdiskriminimi- mbrojtja e fëmijës pavarësisht nga statusi i familjes, origjinës etnike dhe karakteristikave të tjera sociale ose individuale të fëmijës (racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, kombësisë, karakteristikave psikike dhe fizike ose specifike të tjera të fëmijës dhe familjes së tij/saj).

Interesi më i mirë i fëmijës- garanton që interesat më të mira të fëmijës marrin përparësi ndaj interesave të prindit, ose kujdestarit, institucionit ose komunitetit, në situata kur këto interesa ndryshojnë nga interesat e fëmijës.

Pjesëmarrja e fëmijëve- sigurohet duke i mundësuar fëmijëve të marrin informacion të duhur dhe për të shprehur dëshirat, pikëpamjet dhe mendimet e tyre për të gjitha çështjet që i shqetësojnë ata dhe në të gjitha fazat e procesit të mbrojtjes në një mënyrë që i përshtatet moshës së tyre dhe të kuptuarit e situatës.

Mbrojtja e të drejtës për privatësi – fëmijës i garantohet e drejta për privatësi, respektimi i jetës private dhe familjare, mbrojtja e të dhënave personale dhe duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse, arbitrare, dhe të kundërligjshme që prekin moralin, dhe dinjitetin e fëmijës.

Mbrojtja nga dëmtimi i mëtejshëm- veprimet dhe intervenimet që kanë për qëllim t'i mbështesin fëmijët (dhe familjet e tyre apo kujdestarët ligjor), nuk duhet t'i ekspozojnë ata para një dëmi tjetër. Duhet pasur kujdes që të sigurohet se asnjë masë nuk do të çenojë të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve, asnjë dëm nuk u shkaktohet fëmijëve apo familjeve të tyre si rezultat i sjelljes së personave zyrtar, të vendimeve të marra apo të veprimeve të ndërmarra. Duhet pasur po ashtu kujdes që të sigurohet se asnjë dëm nuk u shkaktohet fëmijëve apo familjeve si rezultat i mbledhjes, ruajtjes apo ndarjes së informatave të tyre.

Pjesëmarrja e organizatave shërbim ofruese për fëmijët dhe e organizatave të shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve të PSV-vë, d.m.th. mbrojtjen, parandalimin dhe ndihmën ndaj fëmijëve në punë të rënda. Të gjithë akterët shtetërorë dhe joshtetërorë, përfshirë shoqërinë civile, marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë së monitorimit të punës së fëmijëve. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol kyç, dhe si të tilla, mendimet dhe pikëpamjet e tyre janë të pasqyruara mirë në hartimin dhe zbatimin e këtyre Procedurave Standarde të Veprimit.

► VIZIONI DHE QËLLIMET E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT

Procedurat Standarde të Veprimit në Kosovë synojnë të kontribuojnë në përfshirjen e çështjeve të punës së fëmijëve në sistemet e qeverisjes duke institucionalizuar procesin e identifikimit dhe largimit të fëmijëve nga format e rrezikshme të punës së fëmijëve.

Rrjedhimisht, vizioni i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) është që nëpërmjet zbatimit të këtij dokumenti institucionet e Republikës së Kosovës të sigurojnë mbrojtje më të mirë të fëmijëve dhe adoleshentëve, dhe që këto procedura të përmirësojnë reagimin e shtetit ndaj rasteve të punës së rrezikshme të fëmijëve; viktimat të mbrohen nga viktimizimi sekondar dhe të inkurajohen, të sigurohen e të fuqizohen për t'u mbrojtur nga punët e dëmshme dhe abuzive si dhe të ri-integrohen në një shoqëri të shëndoshë.

Qëllimi i PSV është krijimi i një sistemi proaktiv, referues, reagues, dhe të koordinuar të institucioneve të Kosovës, të cilat duhet të reagojnë në formë të menjëhershme dhe të vazhdueshme në rastet e punës së rëndë të fëmijëve me qëllim të parandalimit, referimit, ofrimit të ndihmës cilësore, shërbimeve të integruara dhe mbrojtjes së fëmijës. Dokumenti ka për qëllim të qartësojë rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente në mbrojtjen e fëmijëve përmes identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe rehabilitimit si dhe reintegrimit. Me masa aktive dhe reaktive ligjore mbrohet fëmija/adoleshenti dhe ndëshkohet shfrytëzuesi.

PSV-te në mënyrë të veçantë synojnë:

- Identifikimin, referimin, tërheqjen, përkrahjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës,
- Dokumentimin e vazhdueshëm të trendeve dhe shtrirjes së punës së fëmijëve sipas lokacioneve gjeografike dhe sektorëve dhe
- Vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të masave ekzistuese në nivelin qendror dhe në ate local, përfshirë edhe rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe zhvillim/avansim të vazhdueshëm të politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes.
- Realizimi i qëllimeve të PSV arrihet përmes:

- Përbushjes së obligimeve të akterëve përgjegjës për monitorimin e punës së fëmijëve
- Ndërmarrjes së masave ligjore në zbatimin e procedurave të identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe reintegrimit
- Bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet akterëve institucional për reagimin ndaj rasteve të punës së fëmijëve përmes ofrimit të shërbimeve të integruara
- Zbatimin e masave të nevojshme të trajtimit në institucionet gjegjëse si dhe masave të rehabilitimit dhe reintegrimit të fëmijëve.

Monitorimin, raportimin, vlerësimin dhe zbatimin e mbrojtjes nga punët e rënda nga akterët përgjegjës.

Monitorimi i procedurave standarde të veprimit për fëmijët në punë

PSV-të shërbejnë dhe veprojnë si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivel komunal. Në nivelin komunal, i gjithë procesi përfshinë menaxhimin e rasteve të fëmijëve të identifikuar dhe monitorimin e dukurisë së punës së fëmijëve në vazhdimësi, përfshirë monitorimin e vendeve të punës, shkollave/shërbimeve dhe komunitetit. Procesi synon të siguroj se vajzat dhe djemtë nuk janë të përfshirë në format e rrezikshme të punës por janë në shkolla. Këto PSV:

- ▶ Janë të aplikueshme për të gjitha kategoritë e FRRPF të përcaktuara nga Ministria përkatëse në listën e FRRPF
- ▶ Veprojnë në nivel lokal, mbulojnë vendpunishtet/shkollat/familjet dhe përfshijnë sistemin e referimit në shërbime
- ▶ Mbështeten në autoritetin e qeverisë lokale dhe qendrore
- ▶ Ndërlidhen me politikat dhe veprimet kombëtare mbi MF
- ▶ Ngriten mbi sistemet ekzistuese të menaxhimit të informacionit

Monitorimi i zbatimit të PSV-ve në nivel lokal është i vendosur në Drejtoritë përkatëse të Mirëqenies Sociale (DKMS). DKMS do të koordinojnë procesin në nivel lokal. Në nivel qendror, zbatimi I PSV-ve do të menagjohet nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familje.

Ekipi për të Drejtat e Fëmijës që do të themelohet në të gjitha komunat, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, ndër të tjera ka përgjegjësi:

- ▶ Definimin e prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të koordinojë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e tyre;
- ▶ Zhvillimin e programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në fenomene të mundshme negative dhe ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët;
- ▶ Rekomandimin për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi;

Monitorimi i zbatimit të PSV-ve në nivel lokal është i vendosur në Drejtoritë përkatëse të Mirëqenies Sociale (DKMS).

Harta konceptuale e monitorimit të punës së fëmijëve në Kosovë që është dhënë në vijim tregon lidhjet midis niveleve qendrore dhe lokale të qeverisjes sa u përket roleve të tyre në zbatimin e PSV-ve, akterët e ndryshëm të ndërlidhur, funksionin e tyre dhe përshkruan rezultatet e synuara.

AUTORITETET E NIVELIT QENDROR				
Zhvillimi i arsimit Siguria në punë Edukimi dhe trajnimi profesional	Mekanizmat përkatës për parandalimin dhe ndalimin e FRRPF Ligjet dhe politikat Mbikqyrja e zbatimit të legjislationit Zotimet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	Marrëdhëniet industriale Punësimi i denjë i rinisë Zhvillimi i bizneseve të vogla Mbrojtja sociale		
DEPARTAMENTI PËR POLITIKA SOCIALE DHE FAMILJE				
<p>Plani i veprimit kundër punës së fëmijëve- me masa parandaluese dhe mbrojtëse</p> <p>Monitorimi i situatës së punës së fëmijëve dhe koordinimi i veprimeve kundër saj</p> <p>Planifikimi, organizimi dhe përgatitja e modulit të trajnimeve në baza të rregullta për stafin e institucioneve përkatëse që kanë të bëjnë me parandalimin dhe ndalimin e punëve të rrezikshme për fëmijët.</p> <p>Përkrahja e strukturave komunale për monitorimin dhe zbatimin e PSV-ve për fëmijët në punë</p> <p>Monitorimi dhe koordinimi i zbatimit të PSV-ve në nivel komunal</p> <p>Përkujdesja që informatat e mbledhura nga niveli komunal të përcillen në atë qendror dhe anasjelltas</p>				
KOMUNAT/ EKUPI PËR TË DREJTAT E FËMIJËS/QPS				
<p>Definimi i prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme për përmirësimin e situatës</p> <p>Zhvillimi i programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në punë dhe për të ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët;</p> <p>Monitorimi i zbatimit e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e PSV-ve</p> <p>Identifikimi, referimi, tërheqja nga puna, mbrojtja e fëmijës, rehabilitimi dhe reintegrimi, puna me familjen</p>				
MONITORIMI I VENDEVE TË PUNËS		MONITORIMI I SHKOLLAVE/ SHËRBIMEVE		MONITORIMI NË KOMUNITET
Inspektorët e punës, bujqësisë, pylltarisë Inspektorët komunal Punëdhënësit dhe punëtorët Punëtorët socialë OJQ-të, ekspertët e shëndetit dhe të sigurisë në punë, ekspertët shëndetësorë, Policia, shkollat, anëtarët e familjes, OJQ-të		Punëtorët socialë, inspektorët e arsimit, mësimeve, Zyrtarët Komunal për të Drejta të Fëmijës, drejtoritë komunale të arsimit, nëpunësit e shërbimit sprovues, avokatët e viktimave, asociacionet e prindër-mësimdhënës, ofruesit e shërbimeve, grupet e fëmijëve/të rinjëve, familja		Punëtorët socialë, shërbimi komunal i bashkësisë, njësia e policisë në bashkësi, grupet bashkiake, grupet e femrave, grupet e fëmijëve/të rinjve, qendrat rinore
SHËRBIMET E OFRUARA				
Inspektimi i rregullt i fabrikave, ndërmar- rjeve të vogla dhe të mesme, fermave, pikave të grumbullimit të mbeturinave, treg- jeve, rrugëve, shtëpive, vendpunishëve të ndërtimtarisë	Inspektimi për respektim të standardeve bazë të punës	Rehabilitimi Shërbime psiko- sociale Shërbime sprovuese Qasje në edukim dhe/ose alternativa të përshtatshme për reintegrim social dhe ekonomik	Ngritja e vetëdijes dhe veprimi për të adresuar punën e fëmijëve	
REZULTATET E SYNUARA				
Fëmijët në format e rrezikshme të punës janë identifikuar	Fëmijët me moshë 15 deri 18 vjet kanë kushte më të mira të punës. Fëmijët nën 15 vjeç janë evakuar	Arsimim themelor cilësor për të gjithë fëmijët	Fëmijët kanë alterna- tiva më të mira për të ardhmen	Komunitetet janë të përkushtuara dhe të angazhuara në luftën kundër punës së fëmijëve

► FUNKSIONALIZIMI NË NIVEL LOKAL

Ekipet për të Drejtat e Fëmijës janë struktura komunale me mandat për të zbatuar politikat dhe prioritetet programore për mbrojtjen e fëmijëve nga format më të këqija të punës, përmes zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe zbatimit të PSV-ve².

Shtirirja dhe funksionalizimi i PSV-ve në nivel komunal është përshkruar përmes pesë hapave konkret më poshtë:

Hapi 1: Vendosja e institucionit udhëheqës për monitorimin e zbatimit të PSV-ve në nivel komunal

Ekipet për të Drejtat e Fëmijëve do të jenë struktura e themeluar në kuadër të strukturave lokale qeverisëse me qëllim që të udhëheqin, mbikqyrin dhe koordinojnë zbatimin e PSV-ve në komunën përkatëse.

EDF duhet të ketë në përbërjen e vet Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin e Komunës si dhe anëtarët nga Drejtoritë përkatëse për arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, buxhet dhe financa. Poashtu në cilësinë e anëtarëve vëzhgues, EDF përbëhet edhe nga përfaqësuesi i fëmijëve, prindërve, Avokati i Popullit, TMR-të, si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Kryesuesi dhe zëvendës-kryesuesi i Ekipit e kanë detyrë të menaxhojnë dhe koordinojnë aktivitetet e kësaj strukture ndërinstucionale. Megjithatë, secili anëtarë i përfshirë në ekip luan rolin e koordinuesit për institucionet e subordinuara të cilat i përfaqëson në EDF. Funkcionet e të gjitha strukturave udhëheqëse duhet të përfshijnë shqyrtimin periodik dhe vlerësimin e gjendjes operative si dhe të kualitetit të përpjekjes monitoruese. Monitorimi i implementimit të PSV-ve shërben për disa qëllime:

- Mban përgjegjës secilin nga institucionet sa i përket përmbyshjes së obligimeve ligjore.
- Mundëson identifikimin e zbrastësive në PSV, legjisllacion dhe praktikat aktuale.
- Informatat e mbledhura përmes monitorimit dhe vlerësimit ndihmojnë përmirësimin e PSV-ve, strategjive për monitorimin e punës së fëmijëve dhe në formulimin e legjisllacionit në të ardhmen.
- Ndhmon në vlerësimin e nevojës për vetëdijësim për parandalimin, raportimin dhe luftimin e punës së fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve të integruara.

Monitorimi dhe vlerësimi i përditshëm i implementimit të PSV-ve duhet të bëhet edhe përbrenda secilit institucion. Secili institucion që është përgjegjës për implementimin e PSV-ve është i obliguar edhe ta monitoroj dhe vlerësoj implementimin e tyre – sipas zinxhirit hierarkik (p.sh Policia e monitoron strukturat e veta në zbatimin e PSV-ve përbrenda departamenteve dhe njërive të saj, dhe gjatë raportimit të rregullt të njërive të ndryshme vlerësohet edhe implementimi i PSV-ve).

Funksionet e EDF si trup menaxhues dhe koordinues i PSV-ve në nivel komunal janë si vijon:

- mbikqyrja dhe udhëheqja e procesit të monitorimit (monitorimin, koordinimin e sistemit të referimit si dhe ofrimin të shërbimeve, dhe shfrytëzimin aktiv të informatave të nxjerra nga procesi i monitorimit për vendosjen e prioritetëve të intervenimit);
- ofrimi i udhëzimeve dhe ndihmës për partnerët e involvuar në monitorimin e punës së fëmijëve dhe të zbatimit të PSV-ve;
- përkujdesja që resurse adekuate (materiale dhe njerëzore) t'i vihen në dispozicion për monitorimin e zbatimit të PSV-ve dhe monitorimin e punës së fëmijëve;
- shqyrtimi dhe vlerësimi periodik i kualitetit të monitorimit dhe planifikimin e masave korrigjuese; dhe
- shqyrtimi dhe përcjellja e vazhdueshme të raporteve përmbledhëse të MPF me qëllim të planifikimit të masave vjetore për adresimin e punës së fëmijëve në komunën përkatëse dhe me qëllim të ofrimin të rekomandimeve për zhvillimin e politikave sociale në nivel komunal por dhe shtetëror.

Ekipi harton dhe miraton planin e veprimit (Shih Shtojca 2) për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi bazuar në mandatin dhe përgjegjësitë e Ekipit të paraparë me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Ky Plan duhet të hartohet konform planit zhvillimor Komunal dhe duhet të reflektojë interesat afatgjata të fëmijëve.

Në procesin e zbatimit të PSV-ve është qenësore të përcaktohet mënyra e funksionimit të ekipit, mënyra e komunikimit dhe rolet e përgjegjësitë e secilit departamentet/institucion anëtar.

Hapi 2: Zhvillimi i procesit të menaxhimit të rastit

Sistemi i menaxhimit të rastit të fëmijëve është i detajuar në PSV dhe ka për synim që të identifikohen fëmijët, të referohen dhe të ndërmerren masa për:

- ▶ t'u përkujdesur për përcaktimit e rrezikshmërisë për fëmijën dhe tërheqjen fizike të fëmijës nga vendi i punës nëse ka rrezik të pashmangshëm për fëmijën (gjendjet si: ekspozimi ndaj materieve të rrezikshme kimike, prostitucioni, puna ku fëmija është i lidhur etj.);
- ▶ ofrimin e shërbimeve alternative për fëmijët e tërhequr nga puna siç është shkollimi ose/ dhe trajnimi profesional, dhe masa të tjera mbështetëse për të adresuar shkaqet që fëmijën e kanë detyruar/shtyrë të punoj dhe
- ▶ përcjelljen për tu siguruar që fëmija më vonë nuk është kthyer në punë, në ndonjë sektor tjetër të punës së fëmijëve.

Aspekti më i rëndësishëm për EDF në këtë kontekst është hartimi i procedurës përmes së cilës aktivizohet sistemi i referimit dhe krijimi i sistemit të koordinimit. Është me rëndësi që EDF të krijojë protokolin i cili përfshin kriteret dhe procedurat që duhet ndjekur për bazhkëdyzimin dhe koordinimin e aktiviteteve mes të gjitha institucioneve ndërlidhese në procesin e menaxhimit të rastit për fëmijën. Si rezultat i këtij hapi EDF duhet zhvilluar sistemin e identifikimit dhe referimit të fëmijëve të përfshirë në punë dhe kriteret e tërheqjes dhe të largimit që u mundësojnë fëmijëve punëtorë të marrin ndihmë (asistencë) përkatëse përmes rrjetit të ofruesve të shërbimeve

Në dokumentin e PSV-ve janë detajuar hapat në identifikim dhe referim të rasteve, si dhe përgjegjësitë e institucioneve ndërlidhëse në këtë aspekt.

Hapi 3: Zhvillimi i mjeteve/instrumenteve të

ne ojshme për identifikimin dhe monitorimin e fëmijëve në punë, planifikimin e masave të nevojshme dhe raportimin e rregullt mbi situatën, arritjet dhe sfidat në adresimin e punës së fëmijëve

Aktivitetet në këtë hap përfshijnë zhvillimin dhe testimin e mjeteve të monitorimit, mbledhjen e informatave për punën e fëmijëve, dokumentimin e tyre dhe planifikimin e intervenimit në nivel komunal bazuar në ato të dhëna.

Ekzistojnë së paku tri grupe themelore të të dhënave që duhet të mblidhen:

- a. informatat lidhur me fëmijën dhe punën ku është i përfshirë,
- b. informatat lidhur me nevojat dhe shërbimet ekzistuese në komunë dhe
- c. informatat lidhur me familjen.

Për evidentimin e këtyre të dhënave Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes-MFPT ka përgatitur një formë të vecantë që gjindet e bashkangjitur në Shtojcën 1. Megjithatë ka dhe modalitete tjera kur për secilin grup të të dhënave kërkohet të zhvillohet një formë specifike.

Mbledhjen e të dhënave në nivel lokal, apo nevojën për të dhëna shtesë e përcakton EDF. Informatat e mbledhura për fëmijën mund të organizohen (sistemohen) sipas statusit të tij/saj sa i përket punës së fëmijës. Të gjithë akterët e ndërlidhur duhet të pajtohen se cilat informata duhet të mblidhen, si do të shfrytëzohen këto informata dhe kush do të ketë qasje në këto informata.

Me qëllim të posedimit të një strategjie konkrete për zbatimin e PSV-ve në nivel lokal, sugjerohet që EDF-të në bazë të situatës së evidentuar të punës së fëmijëve në komunën përkatëse të përgatisin planet komunale të veprimit për periudhë një vjeçare (shih Shtojca 2). Planet e Veprimit do të ndihmojnë në planifikimin e intervenimeve me prioritet me qëllim të adresimit të nevojave të fëmijëve, ndarjes së përgjegjësi në realizimin e aktiviteteve të parapara me planin e veprimit dhe menaxhimin më të lehtë të procesit në përgjithësi.

Hapi 4: Zhvillimi i modelit për monitorimin e zbatimit të PSV-ve

Monitorimi i Punës së Fëmijëve dhe monitorimi i zbatimit të PSV-ve është një proces i vazhdueshëm

dhe institucionet përkatëse posedojnë të dhëna specifike për fëmijët. Këto institucione mbledhin dhe ofrojnë të dhëna për natyrën e punës në sektor formal, joformal, llojet dhe rreziqet e caktuara, nevojat dhe shërbimet në dispozicion dhe që nuk janë në dispozicion, suksesin ose mosesuksin e një procedure intervenuese etj. dhe në këtë mënyrë ofrojnë mundësi për dizajnim të politikave dhe qasjeve intervenuese qoftë në nivel komunal qoftë në atë qendror. Me anë të analizave specifike të dala nga MPF, mund të arrihen përfundime dhe sugjerime për intervenime të mëtejme.

Është e rëndësishme që partnerët e monitorimit të punës së fëmijëve të kenë njohuri të mira themelore lidhur me kushtet e punës dhe vlerësimin e rreziqeve të shëndetit dhe të sigurisë profesionale.

Monitorimit të Punës së Fëmijëve dhe i zbatimit të PSV-ve duhet të testohet dhe analizohet në tre nivele:

- Monitorimi në vendin e punës dhe në komunitet
- Referimi dhe veprimet përcjellëse
- Transferimi i informatave monitoruese në nivelin lokal dhe kombëtar

Verifikimi i veprimeve referuese dhe përcjellëse është i një rëndësie të vecantë, ai duhet të analizohet e të vlerësohet gjatë gjithë kohës, dhe të reflektohet në raportet progresive mbi planin e veprimit.

Pas marrjes së informacionit mbi funksionimin e PSV-ve, nga institucionet e ndryshme në nivel lokal, EDF duhet t'i evidentoj këto të dhëna dhe të vlerësojë nëse ato kanë përmbushur aktivitetet e parapara me planin e veprimit. Bazuar në këto reflektime, dhe bazuar në vecanti në të dhënat e konsoliduara të pranuar nga QPS, koordinatori duhet të përgatis raportin progresiv mbi situatën e punës së fëmijëve në nivel lokal dhe funksionimin e sistemit referues përfshirë këtu dhe numrin e shërbimeve të ofruara në kuadër të sistemit referues. Në bazë të analizës së situatës të dalë nga terreni, EDF vlerëson se cilat do duhej të ishin veprimet vijuese dhe në këtë mënyrë përgatit një plan të ri veprimi për periudhën vijuese.

Planin i Veprimit adresohet për miratim në Kuvendin Komunal. Pas miratimit implementohet nga institucionet vepruese në nivel lokal të cilat i raportojnë kryesuesit të EDF-së për progresin dhe sfidat eventuale gjatë implementimit. Kryesuesi

konsolidon të dhënat dhe i prezanton në EDF me crast jipen rekomandime dhe përgatit planin komunal i veprimit për vitin vijues. Si për çfarëdo procesi tjetër të mbledhjes dhe dokumentimit të të dhënave, është me rëndësi që të matet vazhdimisht ndikimi i sistemit dhe të përmirësohet funksionimi i tij si dhe të mbahet i thjeshtë, efikas (sa i përket shpenzimeve) dhe i qëndrueshëm.

Hapi 5: Zhvillimi i një komunikimi të mirëfilltë ndër-sistemik.

Me qëllim të mirëmbajtjes së lidhjeve ndërmjet veprimeve të nivelit lokal dhe përpjekjeve politike të nivelit kombëtar, është me rëndësi të raportohen informata në baza të rregullta. Është identifikimi i vazhdueshëm i punës së fëmijëve dhe veprimi i menjëhershëm i cili dallon monitorimin e zbatimit të PSV-ve nga shumë mjete të tjera të mbledhjes së të dhënave dhe sjell informatat të cilat mblidhen më afër vendimmarrjes.

Të dhënat mund të përdoren për parandalim dhe avokim, dhe për ta rritur bashkëpunimin dhe koordinimin midis ofruesve të shërbimeve sociale. Është me rëndësi të dokumentohen si duhet qasjet inovative lidhur me atë se si shfrytëzohen në praktikë informatat mbi punën e fëmijëve për veprimet lokale kundër punës së fëmijëve dhe si ndahen ato midis të agjencive partnere.

Andaj EDF raporton një herë në vit për të arriturat mbi planin e veprimit dhe këtë raport i bashkangjet edhe konsolidimin e të dhënave për fëmijet në punë për komunën e vet (shih Shtojca 3). Më pas EDF, bazuar në pasqyrën një vjeçare të intervenimit, planifikon dhe sugjeron intervenimet për periudhën vijuese përmes një projekti propozimi për të cilin kërkon fillimisht mbështetje nga Asambleja Komunale. Niveli i mbështetjes poashtu raportohet në qarqet më të larta Qeverisëse.

Hapat e zbatimit të menaxhimit të rastit dhe masave të PSV-ve

HAPI 1: Parandalimi

Parandalimi është masa e parë në PSV. Ajo përfshin veprimtaritë që ndërliken me:

1. Monitorimi i situatës së fëmijëve në punë me qëllim identifikimin e mangësive në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe planifikimin e masave për adresimin e tyre. Kjo përfshin veprimet në vijim:

- ▶ Vlerësimi vjetor në nivel vendi i situatës së përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve në punë
- ▶ Takime vjetore me fokus analizën vendore të shkaqeve bazuar në të dhënat e përfituara nga rastet konkrete të punës së fëmijëve
- ▶ Vlerësimi vjetor në nivel komunal i situatës së përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve në punë
- ▶ Takime periodike në nivel komune për analizën e shkaqeve bazuar në të dhënat e përfituara nga rastet konkrete të punës së fëmijëve në komunën përkatëse

2. Informimi dhe vetëdijësimi i popullatës së përgjithshme dhe grupeve të vecanta të popullatës për pasojat negative të punës së fëmijëve dhe pasojat ligjore të shfrytëzimit të fëmijëve për punë të këqija. Kjo përfshin veprimet në vijim:

- ▶ Informimi dhe vetëdijësimin e fëmijëve dhe shkollave gjatë vizitave sistematike të mjekëve në shkolla
- ▶ Takime me prindërit në shkolla dhe në komunitete për informim rreth punës së fëmijëve nga ana e mësimdhënësve dhe shkollave x
- ▶ Informimi dhe vetëdijësimi i familjeve gjatë vizitave familjare dhe takimeve për skemat e ndihmës sociale dhe shërbimet sociale, nga QPS-të
- ▶ Vetëdijësimi i punëdhënësve për pasojat e angazhimit të fëmijëve në punë të rrezikshme, nga Inspektorati i Punës dhe Organizatat e Punëdhënësve
- ▶ Vetëdijësimi i fermerëve mbi format e rrezikshme të punës në bujqësi, efektin negativ në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe masat për parandalimin/ tërheqjen e

fëmijëve nga ky angazhim, nga Shërbimet Këshillimore të Drejtorive Komunale të Bujqësisë dhe mekanizmat qendror të MBPZHR

- ▶ Vetëdijësimi i familjeve për rreziqet dhe pasojat e angazhimit të fëmijëve në aktivitete të rrezikshme bujqësore, nga shkollat
- ▶ Fushata vjetore vetëdijësuese për popullatën e përgjithshme, nga të gjitha institucionet sipas mandatit që kanë.

Masat tjera parandaluese përfshijnë:

- ▶ Vendorsjen e bashkëpunimit ndërinstitutional për koordinimin e punës, shkëmbimin e informatave përkatëse;
- ▶ Informimin dhe sensibilizimin e fëmijëve të përfshirë në FRRP, familjarëve të tyre dhe publikut të gjerë për efektet e dëmshme të FRRP së fëmijëve;
- ▶ Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që zhvillojnë programe në parandalimin dhe eliminimin e FRRP të fëmijëve
- ▶ Trajnime të vazhdueshme nëpër regjione me të gjitha institucionet përgjegjëse për parandalim të punës së fëmijëve në përputhje me mandatin e tyre ligjor
- ▶ Intervenimi në kurikulat shkollore rreth vetëdijësimin të fëmijëve për të drejtat e tyre dhe rreziqet nga aktivitete të ndryshme punuese dhe detyrimin e prindit apo kujdestarit dhe shtetit për të siguruar mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijës, edukimin dhe shkollimin, si dhe mbajtjen me plotësimin e të gjitha kushteve për jetë normale.
- ▶ Sensibilizimi i të gjithëve për detyrimin ligjor dhe qytetarë për raportimin e rasteve të fëmijëve në punë të rrezikshme
- ▶ Vetëdijësimi i institucioneve shkollore, shëndetësore, inspektorateve, si dhe institucioneve tjera që kanë kontakt me fëmijët që të referojnë rastet në momentin që mësojnë se një fëmijë është abuzuar në ndonjë nga format, përfshirë edhe format e rënda të punës së fëmijëve, si dhe sensibilizimi i tyre se mos lajmërimi i veprave të tilla penale gjatë kryerjes së detyrës të tyre zyrtare dhe mos referimi në organet kompetente të hetuesisë përbën veprë penale për ta.
- ▶ Organizimi i fushatave sensibilizuese dhe vetdijësuese për format e rrezikshme të

punës së fëmijëve në bujqësi, përfshirë pylltarinë, si dhe këshillime për mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve: (a) përmes takimeve individuale e grupe me fëmijë, prindër, mësime dhënë, fermer, punëdhënë/operator; (b) përmes mediave, materialeve informative, takimeve të drejtpërdrejta informuese dhe këshilluese;

- Pjesëmarrja në programe të ndryshme mediale (TV apo radio) që kanë për qëllim sensibilizimin e opinionit për efektet negative të punës së fëmijëve;

HAPI 2: Identifikimi dhe referimi

Faza e Identifikimit është faza e dytë e PSV-së, por faza në të cilët fillon ndërhyrja e targetuar në viktimit. Ajo përfshin tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, lokale dhe qendrore, përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, që përcaktojnë se një person i/e mitur është viktimë e mundshme e punës së fëmijëve. Kjo masë përfshin kontaktin me fëmijën dhe potencialisht familjen e fëmijës, vlerësimin e shpejtë të situatës së fëmijës, mbledhjen e informacionit për fëmijën dhe situatën familjare, mbledhjen e informacionit për punëdhënësin e dyshuar, informimin e kujdesshëm të fëmijës (dhe potencialisht familjes) për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion, për detyrimet që ka shteti për mbrojtjen e tyre, dhe informimin për alternativat e kujdesit për fëmijën.

Identifikimi i fëmijës, viktimë e supozuar e angazhimit në punë të fëmijëve, mund të ndodhë si rezultat i një ngjarjeje të vetme (një dëshmitar e raportin rastin) apo mund të jetë identifikim pas përcjelljes së fëmijës në disa raste të mundshme. Ndaj edhe informacionet në dispozicion me rastin e identifikimit dhe referimit mund të jenë të mangëta apo më të detajuara.

Organi përgjegjës për referimin fillestar është institucioni që vepron si pikë e referimit dhe mbështetjes fillestare (shkolla, mjekësia familjare, policia, OJQ-të, etj) dhe që duhet të reagojë në rastin e identifikuar. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, çdo person që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që fëmija mund t'i nënshtrohet, ose që ndaj fëmijës është ushtruar ndonjë formë e dhunës fizike ose mendore, keqtrajtim, braktisje, abuzim, neglizhim dhe shfrytëzim është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në polici ose në Qendrën përkatëse për punë sociale (Neni 26, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës).

Referimi parasheh raportim zyrtar të një shqetësimi për një fëmijë në rrezik të dëmtimit nga ndonjë person, profesionist, institucion ose organizatë brenda komunitetit. Referimi i fëmijës mund të bëhet drejtpërdrejt në QPS, përmes telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit. Sipas Kornizës së Standardeve Minimale për Shërbimet e Punës së Fëmijëve, çdo partner i mandatuar rastin e identifikuar do t'ia paraqes QPS-së brenda një maksimumi prej 24 orësh nga koha e identifikimit të rastit të tillë.

Për çdo rast të referuar këto struktura duhet të plotësojnë formularin përkatës, nga Udhëzuesi për Menaxhimin e Rastit, që ndodhet në shtojcë të PSV-ve. Forma e plotësuar dërgohet në QPS dhe të dhënat e rastit regjistrohen në Databazë.

Informacioni bazë i nevojshëm për referimin e rastit përmban informacione mbi mënyrën se si mund të qasemi te fëmija, informacione thelbësore në lidhje me arsyen pse bëhet referimi, rreziqet të cilave fëmija i ekspozohet, detajet për zyrtarin e punës sociale që ka marrë njoftimin dhe datën kur është bërë referimi. Çdo dokument i dorëzuar me rastin e referimit duhet të regjistrohet.

Pasi rasti është referuar, nëse zyrtarët institucional në bazë të informacionit të mbledhur vlerësojnë se fëmija është viktimë e mundshme e trafikimit ose viktimë e trafikimit, atëherë, vazhdohet procedura sipas PSV-ve për viktimat e trafikimit.

Sapo identifikohet një fëmijë i angazhuar në punë të fëmijëve, ose në rast se ka baza të arsyeshme për të besuar që personi është viktimë e angazhimit në punë të fëmijëve, QPS duhet të emërojnë një menaxher rasti për ta shoqëruar fëmijën gjatë gjithë procesit dhe deri sa të gjindet dhe të vihet në jetë një zgjidhje e qëndrueshme në interesin më të mirë të fëmijës.

PSV-ja detajon përgjegjësitë e të gjitha institucioneve në rast të identifikimit dhe referimit të rastit të fëmijës në punë.

Ndarja e informacionit me të tjerë është një komponent thelbësor i referimit. Pika e parë e njoftimit duhet t'ua japë informacionin të tjerëve (akterëve përkatës- policia, prokuroria, inspektorati, etj) dhe t'i trajtojë menjëherë nevojat urgjente të viktimave të supozuara.

Institucioni identifikues nuk duhet t'i bëjë pyetje apo të marrë në pyetje fëmijën përse kohë që QPS nuk është njoftuar dhe viktimat nuk është informuar plotësisht mbi të drejtat e saj/të tij, mbi opsionet,

mbi proceset në vijim, mbi mundësitë e saj/të tij që të për të bërë pyetje, për të shprehur shqetësimet dhe paraqitur kërkesat.

Hapi 3: Vlerësimi i rastit (fillestar dhe gjithëpërfshirës)

Vlerësimi fillestar ka për qëllim identifikimin e rrezikut të menjëhershëm dhe përcaktimin e veprimeve prioritare të shpëtimit. Të dhënat që duhet të mblidhen për këtë qëllim përfshijnë: informacione të përgjithshme për fëmijën, informacione mbi natyrën e punës (sektori dhe rreziqet që i ekspozohet fëmija) dhe kategorizimi i nivelit të rrezikut. Procesi fillestar i vlerësimit do të përfundohet nga MR brenda 2 orëve.

Gjatë vlerësimit, përpos konfirmimit të dyshimeve, qëllimi është që të mësohet nëse ka ndonjë rrezik të shpejtë për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës, ku ndër të tjera vlerësohen edhe rreziqet për fëmijën nga mjedisi, mjetet, natyra apo kohëzgjatja e punës. Shqyrtimi i rrezikut është një diskutim i dyanshëm midis MR dhe viktimës së supozuar, dhe palëve tjera të përfshira. Nëse përcaktohet rreziku i menjëhershëm ose konfirmohen dyshimet për angazhimin e fëmijës në punë të rënda mirret edhe vendimi për tërheqje të fëmijës nga puna dhe referimi për shërbime. Tërheqja nënkupton largimin e fëmijës së identifikuar si fëmijë i rrezikuar nga puna përmes ofrimit të shërbimeve që përkojnë me nevojat e tij/saj dhe familjes.

Përveç menaxherit të rastit, mund të jetë e nevojshme që të përfshihen edhe përfaqësues tjerë të shërbimit social. Nëse vlerësimi nxjerr në pah se niveli i rrezikut është i mesëm ose i ulët, që do të thotë se nuk ka rrezik të menjëhershëm për jetën ose sigurinë e fëmijës, atëherë MR do të vazhdojë me vlerësimin. Nëse niveli i rrezikut është i lartë atëherë fillimisht nevojitet veprim i menjëhershëm për ta shpëtuar fëmijën nga rreziku.

Pas përfundimit të vlerësimit, në bazë të vëzhgimit dhe bashkëbisedimit me fëmijën dhe/ose të rriturit që e shoqërojnë atë, zyrtarët e shërbimeve sociale gjykojnë për formën dhe mënyrën e ndihmës së menjëhershme të fëmijës. Forma dhe mënyra e ndihmës së menjëhershme përcaktohet në varësi të gjëndjes së përgjithshme shëndetësore, fizike, emocionale dhe të sigurisë së fëmijës dhe nivelit të rrezikut.

Vlerësimi gjithëpërfshirës është vlerësim i thelluar që synon t'i japë MR kuptim tërësor të situatës së fëmijës, të gjenerojë informacion për të udhëzuar zhvillimin e planit të shërbimeve dhe për t'i identifikuar aspektet që mund të përdoren për të informuar vendimet e MR lidhur

me natyrën e ofruesve të tjerë të shërbimeve që mund të ndërhyjnë në situatën e fëmijës për t'i adresuar shqetësimet specifike. Vlerësimi duhet të mbulojë nevojat fizike, psikologjike, emo-

cionale dhe sociale, duke përfshirë të kuptuarit e karakteristikave kulturore të mjedisit, si dhe hartëzimin e shërbimeve në dispozicion në komunitetin ku fëmija jeton.

Vlerësimi i nevojave duhet të bëhet në konsultim të ngushtë me fëmijën dhe familjen e tij. Si rrjedhojë, hapi i parë dhe më i rëndësishëm është angazhimi dhe krijimi i marrëdhënies me fëmijën, ndërtimi i besimit dhe bërja e situatës sa më të përshtatshme dhe të sigurt. Si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm, MR duhet të krijojë dosje të të gjitha të dhënave, informacioneve dhe përfundimeve përkatëse për profilin e rastit bazuar në ato informacione. Përmbajtja e dosjes së fëmijës ruhet në fshehtësi të lartë dhe vihet në dispozicion vetëm për profesionistët që janë duke punuar mbi rastin.

Vlerësimi gjithëpërfshirës është një vlerësim më i plotë i cili përqëndrohet kryesisht tek nevojat e fëmijës, të familjes dhe të sigurisë së tyre, i cili përpiqet të identifikojë:

- Rrezikun ndaj fëmijës në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë;
- Nevojat e gjithanshme të fëmijës në lidhje me moshën dhe zhvillimin e tyre;
- Pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e familjes (sipas rastit, përfshirë edhe familjen e gjerë).

Qëllimi përfundimtar i këtij vlerësimi është të fitohet pasqyra e plotë e nevojave dhe aftësive të fëmijës, dhe të hartohet plani individual i shërbimeve, një plan i mbrojtjes dhe përkujdesit individual për fëmijën dhe potencialisht familjen.

Mënyra e realizimit të vlerësimit dhe përgjegjësitë e akterëve në këtë drejtim janë hollësisht të elaboruara në PSV.

Faza e Identifikimit është faza e dytë e PSV-së, por faza në të cilët fillon ndërhyrja e targetuar në viktimën. Ajo përfshin tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, lokale dhe qendrore, përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, që përcaktojnë se një person i/e mitur është viktimë e mundshme e punës së fëmijëve. Kjo masë përfshin kontaktin me fëmijën dhe potencialisht

familjen e fëmijës, vlerësimin e shpejtë të situatës së fëmijës, mbledhjen e informacionit për fëmijën dhe situatën familjare, mbledhjen e informacionit për punëdhënësin e dyshuar, informimin e kujdesshëm të fëmijës (dhe potencialisht familjes) për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion, për detyrimet që ka shteti për mbrojtjen e tyre, dhe informimin për alternativat e kujdesit për fëmijën.

Hapi 4: Planifikimi i shërbimeve individuale

Plani individual i shërbimeve është një përshkrim i qartë dhe i hollësishëm i hapave të mëtejshëm të propozuar për kujdesin ndaj fëmijës dhe familjes. Ky plan është, përgjithësisht, një plan i ndërmjetëm pune.

Pavarësisht nëse fëmija është marrë menjëherë në mbrojtje dhe është vendosur në një institucion përkujdesi apo është shoqëruar në familje dhe ndiqet nga Menaxheri i Rastit, në çdo rast për fëmijën ka një Plan individual të shërbimeve, ku përshkruhet plani i ndërhyrjes.

Hartimi i Planit Individual duhet të marrë në konsideratë faktorët dhe nivelin e rrezikut të fëmijës, nevojat urgjente si dhe faktorët e kontekstit që bëjnë të mundur rehabilitimin dhe integrimin e plotë të fëmijës në familje dhe komunitet. Për hartimin e tij, menaxheri i rastit duhet të marrë në konsideratë dëshirat dhe këndvështrimet e fëmijës, në përputhje me pjekurinë moshore të tij/saj, si dhe mendimet e prindërve, kujdestarëve apo familjes së gjerë nëse fëmija nuk ka prindër/kujdestarë ligjorë.

Procesi i hartimit të planit udhëhiqet nga parimi i Interesit me të lartë të fëmijës. Ky proces dhe përgjegjësitë e secilit institucion në këtë proces janë detajuar hollësisht në PSV.

Hartimi i një plani të shërbimeve kërkon përfshirjen e akterëve të tjerë të rëndësishëm që mund të ofrojnë mbështetjen dhe ndërhyrjet e nevojshme. Një rol i rëndësishëm i MR në këtë fazë është identifikimi i shërbimeve të duhura dhe masave mbështetëse. Përderisa numri i tanishëm dhe shumëllojshmëria e shërbimeve sociale, si publike ashtu edhe private, janë ende të kufizuara, një rol i rëndësishëm i MR është të

avokoj ose të kërkojë ndihmë në emër të fëmijës dhe të rrisë rrjetin e ofruesve të shërbimeve. Kjo do të përfshijë vënien e kontaktit me ofruesit e shërbimeve në dispozicion dhe të mundshëm dhe përshkrimin e nevojave të fëmijës. Një numër referimesh të ndryshme mund të bëhen për fëmijën sipas nevojave të ndryshme të identifikuar.

Të gjitha lidhjet që i mundësohen familjes për marrjen e shërbimeve të ndryshme duhet të dokumentohen dhe të vendosen në dosjen e fëmijës në mënyrë që më pas të bëhet edhe monitorimi dhe përcjella e rastit.

Hapi 5: Mbrojtja dhe rehabilitimi i fëmijëve

Mbrojtja e Fëmijës nënkupton eliminimin, kontrollimin, menaxhimin dhe evidentimin e rreziqeve të ndryshme ndaj të cilave është ekspozuar fëmija, i cili ka aritur moshën minimale për punësim për sigurimin e masave mbrojtëse. Për mbrojtje është me rëndësi që a/ të identifikohen rreziqet dhe vlerësohet rrezikshmëria që bartin ato rreziqe, b/ të sigurohet së janë ndërmarrë masa të kontrollimit/menaxhimit të rrezikshmërisë nga ana e punëdhënësve/prindërve dhe c/ të sigurohet përcjellje e vazhdueshme.

Duke u bazuar në faktin se shumë fëmijë vazhdojnë të mbesin në vendet e punës, përderisa të mos arrihet një pajtueshmëri për planin e tërheqjes së tyre apo për shkak se fëmijët kanë aritur moshën minimale të punësimit (që në Kosovë është 15 vjeç), mbrojtja mund të ofrohet edhe si masë e përkohshme për punë të rrezikshme.

Procesi i **Rehabilitimit dhe Reintegrimit të fëmijës** mbështetet nga ofruesit profesionistë të shërbimeve të cilët janë përgjegjës për sigurinë e fëmijës, shqyrtimin dhe trajtimin e problemeve mjekësore;

shqyrtimin dhe trajtimin e nevojave psikologjike; ofrimin e mbështetjes ligjore; shqyrtimin e rrezikut të paragjykit social dhe lehtësimin e përfshirjes sociale; fuqizimin e përfituesit/të stabilitetit të përfituesit; reintegrimin në sistemin arsimor dhe bashkëpunimin mes ofruesve të shërbimeve drejtim të planifikimit dhe përgatitjes së hapave të mëtejshëm që do të ndërmarrë fëmija.

Kujdesi i rehabilitimit përfshin:

- ▶ trajtimin e vazhdueshëm të nevojave shëndetësore;
- ▶ përkrahjen psiko/sociale
- ▶ rritjen e ndjenjës së pavarësisë dhe të vendim-marrjes së përfituesit (fuqizimi i përfituesit);
- ▶ përfitimin e njohurive dhe aftësive profesionale për një punë të denjë që nuk kategorizohet e rrezikshme dhe nuk është e ndaluar për personat nën moshën 18 vjeçare;
- ▶ përgatitja për integrimin ose për ri-integrimin shoqëror;
- ▶ shqyrtimin e vazhdueshëm të gjendjes së sigurisë;
- ▶ shqyrtimin psikologjik/raportin e progresit;
- ▶ mbështetjen ligjore;
- ▶ mbështetjen financiare;
- ▶ mundësitë e arsimit/të trajnimit profesional, përfshirë dhe fitimin e aftësive për jetën;
- ▶ ofrimi i mësimin të përshtetshëm për fëmijët që kanë humbur mësimin e rregullt, dhe
- ▶ diagnostikimin ose kurimin shëndetësor për probleme të patrajuara deri atëherë.

Ky proces dhe përgjegjësitë e secilit institucion në këtë proces janë detajuar hollësisht në PSV.

Hapi 6: Zbatimi, shqyrtimi dhe monitorimi i rastit

Intervenimi për tërheqjen e një fëmije nga puna e fëmijëve në kuptimin e saj të ngushtë nënkupton zbatimin e planit të shërbimeve dhe vlerësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të realizuara nga të gjithë partnerët, përfshirë ndikimin e tyre në adresimin e nevojave të fëmijës.

Të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të ndryshme dhe janë në një formë osë tjetër të përfshirë në rast, janë të obliguar të bashkëpunojnë me QPS-në dhe në zbatimin e planit dhe përcjelljen e rastit.

Zbatimi i planit të shërbimeve është procesi i

ekzekutimit të masave/aktiviteteve që do të çojnë në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e shërbimeve. Menaxheri i rastit (QPS) duhet t'i përcjellë shërbimet të cilat i ka marrë dhe të cilat i ofrohen fëmijës për të qenë në dijeni me gjendjen e fëmijës. Për këtë qëllim, ai/ajo duhet të zhvillojë komunikime periodike me ofruesit e shërbimeve, me fëmijën dhe familjen e tij/saj.

Shqyrtimi dhe monitorimi i rastit është një proces i vazhdueshëm që synon të sigurojë që shërbimet cilësore ofrohen me kohë, duke i mundur fëmijës të vazhdojë përpara me planin. Ai përqendrohet në atë nëse plani po zbatohet dhe shërbimet po ofrohen, si dhe identifikon çështjet që lidhen me bashkëpunimin e fëmijës/familjes, koordinimin e menaxhimit të rastit

dhe sistemin e ofrimit të shërbimeve. Për t'i monitoruar rrethanat e fëmijës ose ndryshimet që ndodhin si rezultat i ndërhyrjeve në menaxhimin e rastit, përveç monitorimit nga afër të shërbimeve të ofruara, MR duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me fëmijën dhe familjen e fëmijës.

Menaxheri i rastit duhet të verifikojë edhe cilësinë e shërbimeve të cilat i ofrohen fëmijës dhe kontrollimin e informatave të cilat i ofrojnë ofruesit e shërbimeve që të janë të besueshme dhe të sakta. Monitorimi i cilësisë së shërbimeve që i ofrohen fëmijës mund të bëhet përmes vizitave të drejtpërdrejta vëzhguese, takimeve të drejtpërdrejta me personelin përkatës, telefonit, postës elektronike dhe/ose mjeteve të tjera të komunikimit deri në momentin e mbylljes së rastit.

Hapi 7: Dokumentimi

QPS duhet në vazhdimësi të bëjë evidentimin e të dhënave në bazën e të dhënave dhe raportimin mbi zbatimin e planit të shërbimeve. Për këtë, të gjithë partnerët e përfshirë duhet të mbajnë shënime për veprimet e ndryshme në të zbatuara nga ata (p.sh. shkollat, qendrat shëndetësore, inspektorët e punës, policia, ofruesit e shërbimeve do të mbajnë shënime për shërbimet e ofruara, etj.)

Hapi 8: Mbyllja e rastit

Mbyllja e rastit i referohet pikës në të cilën përfundon menaxhimi i rastit. Mbyllja e rastit duhet të jetë e planifikuar mirë brenda planit të shërbimeve, ndërsa fëmija dhe familja e tij duhet të dinë paraprakisht që në një kohë të përshtatshme

shërbimet do të përfundojnë. Fokusi i këtij hapi nuk është thjesht në mbylljen e rastit, por procesi duhet të siguroj që fëmija është në gjendje t'i mirëmbajë arritjet e bëra dhe gjasat e rishfaqjes së problemit janë zvogëluar. Prandaj, rasti nuk «mbyllet» kur përfundon intervenimi, por vetëm pas një periudhe monitorimi, e cila është e mjaftueshme për të parë nëse ndryshimet e arritura janë të qëndrueshme dhe afatgjata. Në të njëjtën kohë, MR duhet të shmangë çytjen e varësisë së fëmijës dhe familjes së tij nga shërbimet sociale.

Hapi 8: Përcjellja e rastit

Menaxheri i rastit (QPS) duhet t'i përcjellë shërbimet të cilat i ka marrë dhe të cilat i ofrohen fëmijës ish punëtorë për të qenë në dijeni me vendndodhjen e fëmijës.

Përcjellja poashtu kërkon që:

- ▶ Policia të përcjell fëmijët e tërhequr nga puna në rrugë,
- ▶ Inspektorët të mbajnë shënime për fëmijët e tërhequr nga sektori formal
- ▶ Partnerët tjerë të cilët janë në gjendje të përcjellin rastet e caktuara të fëmijëve të tërhequr nga puna dhe t'a njoftojnë menaxherin e rastit në baza të rregullta.

Menaxheri i Rastit duhet të zhvillojë komunikime periodike me ofruesit e shërbimeve, me fëmijën dhe familjen e tij/saj.

Hapi 9: Udhëheqja (menaxhimi) dhe analiza e të dhënave

Të gjitha të dhënat e evidentuara mbi rastet e identifikuar të fëmijëve në punë dhe shërbimet e ofruara për ta duhet të konsolidohen dhe si të tilla të shfrytëzohen për veprim dhe për planifikime sociale dhe të politikave lokale dhe shtetërore.

QPS do t'i konsolidojnë këto të dhëna duke përfshirë a/ numrin e përgjithshëm të fëmijëve të referuar në QPS gjatë periudhës raportuese, b/ përmbledhjen e nevojave të fëmijëve të përfshirë në FRPF, c/ shërbimet e ofruara, d/ mungesën e shërbimeve dhe/ apo pengesat për qasje në shërbime, bazuar në raste specifike. Kjo analizë e të dhënave do t'i përcillet EDF-se dhe DKSHMS në baza gjashtëmujore.

Hapi 10: Shfrytëzimi i të dhënave për fuqizim të zbatimit/përmirësim të ligjeve dhe politikave

EDF do të thërras takimet të rregullta për të a/ shqyrtuar të dhënat e konsoliduara, b/ procesin e identifikimit të fëmijëve në punë dhe vendpunishteve, c/ progresin në zbatimin e planit komunal të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga puna dhe c/ mundësitë dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave që kanë të bëjnë me eliminimin e PF.

Informatat për shkeljen e ligjeve lidhur me punën e fëmijëve duhet ti vihen në dispozicion nëpunësve zbatues të ligjit dhe të sistemit ligjor.

Në baza vjetore EDF-të përgatisin raportin komunal mbi situatën e punës së fëmijëve përfshirë:


- ▶ Numrin e fëmijëve në punë, përfshirë ndarjen sipas sektorëve dhe rajoneve gjeografike
- ▶ Profilin e fëmijëve, përfshirë nevojat e fëmijëve në punë dhe familjeve të tyre
- ▶ Shërbimet ekzistuese të ofruara për tërheqjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga puna,
- ▶ Mungesën e shërbimeve apo pengesat në qasje.

Në bazë të analizës së situatës EDF përgatit planin komunal të veprimit kundër punës së fëmijëve


DPSF konsolidon të dhënat nga të gjitha komunat dhe iu prezanton raportin vjetor akterëve kyç, donatorëve dhe partnerëve tjerë të rëndësishëm.

DPSF do të thërras takime me akterët relevant në baza vjetore për të konsoliduar të dhënat e pranuar nga terreni:

- ▶ Mbi trendet e punës së fëmijëve në sektorët dhe/apo rajonet specifike,
- ▶ Shërbimet ekzistuese të ofruara për ta,
- ▶ Mungesën e shërbimeve apo pengesat në qasje dhe
- ▶ Rekomandimet për veprime të mëtutjeshme



SHTOJCAT



► Shtojca 1: Forma për raportimin e situatës së punës së fëmijëve në nivel komunal

KOMUNA: _____ Periudha e raportimit prej: ___/___/___ deri: ___/___/___

1. Numri i fëmijëve të identifikuar/tërhequr gjatë periudhës së raportimit

	Numri total i fëmijëve të identifikuar në format më të këqija të punës					Numri total i fëmijëve të tërhequr/mbrojtur nga format më të këqija të punës				
	Moshë 5-14		Moshë 15-18		Total	Moshë 5-14		Moshë 15-18		Total
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Punë në bujqësi-pylltari										
Punë në rrugë										
Punë në gërmim dhe grumbullim të mbeturinave (deponi)										
Punë në eksploatimin e pasurive natyrore										
Shfrytëzim për aktivitete në konflikt me ligjin ³										
Shfrytëzim për prostitucion dhe pornografi/fëmijë të trafikuar										
Sektorë tjerë që involvojnë aktivitete të ndaluara ⁴ për fëmijët nën moshën 18 vjeçare										
Total:										

³ PSV-të për viktimat e trafikimit dhe të aktiviteteve në konflikt me ligjin janë të vecanta, por në raportimin vjetor mund të pasqyrohet situata e tërësishme e fëmijëve në të gjitha format më të keqja të punës së fëmijëve

⁴ Bazuar në Udhëzim Administrativ QRK nr. 05/2013 për parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë.

Shtrirja gjeografike

Bashkësitë lokale të komunës	Format më të këqija të punës së fëmijëve								
	Punë në bujqësi-pylltari	Punë në rrugë	Punë në gërmim dhe grumbullim të mbe-turinave (deponi)	Punë në eksplo-atimin e pasurive natyrore	Shfrytëzim për aktivite në konflikt me ligjin	Shfrytëzim për prosti-tucion dhe pornografi	Fëmijë të trafikuar	Sektorë tjerë që involvojnë aktivite të ndaluara për fëmijët nën moshën 18 vjeçare	

► 3. Forma e raportimit vjetor mbi punën e fëmijëve në nivelin qendror

Shërbimet e nevojshme për fëmijët e identifikuar në FKPF	Numri i rasteve në nevojë për shërbimin përkatës	Shërbimet në dispozicion		
		Po	Pjesërisht	Jo
Shërbime këshillimi dhe vetdijësi për fëmijë				
Inkuadrim në shkollim të rregullt				
Arsim joformal				
Trajnime aftësi profesionale				
Punësim në forma të lejuara të punës për fëmijë 15-18 vjeç				
Forma të përkrahjes në shkollim/mësim plotësues				
Aplikim i masave mbrojtëse (ndalimi i aktiviteteve të rrezikshme, eliminimi i rreziqeve që ndërlidhen me natyrën e punës)				
Asistencë ligjore				
Aktivite/argetuese/rekreative/vetdijëse				
Shërbime shëndetësore				
Shërbime të mbështetjes materiale				
Sigurimi i një shujte ushqimore në shkollë				
Libra dhe pajisje tjera shkollore				
Skema e asistencës sociale				
Forma tjera të mbështetjes materiale				

Shërbimet e nevojshme për anëtarët e familjeve/familjet e fëmijëve të identifikuar në FKPF	Numri i rasteve në nevojë për shërbimin përkatës	Shërbimet në dispozicion		
		Po	Pjesërisht	Jo
Shërbime këshillimi dhe vetdijësimi				
Trajnime aftësimi profesional				
Aktivitete për gjenerim të të ardhurave (punësim, mjete pune etj.)				
Skema kreditore				
Trajnim për shkrim-lexim bazik				
Shërbime shëndetësore				
Mbështetje materiale				
Skema e Asistencës Sociale				
Pako mujore ushqimore				
Sigurim i vendbanimit/strehimit				

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës
për konsolidimin e të dhënave

Pozita

Nënshkrimi

Data

► Shtojca 2: Forma për Planin Komunal të Veprimit

PLANI KOMUNAL I VEPRIMIT

Objektivat dhe Veprimet	Indikatorët e suksesit	Institucionet/ Personat përgjegjës	Korniza kohore	Rishikimi Vlerësimi në rishikim bëhet me numra: 1: Objektive e përmbushur 2: Objektiva pjesërisht e mbushur 3: Objektiva e pa-arritur		
1	2	3	4	5		
I. OBJEKTIVA AFATGJATE :						
II. Objektivat afatshkurte:						
1. Veprimi/Intervenimi						
1.1. Nënveprimi						
1.2. Nënveprimi						
2. Veprimi/Intervenimi						
2.1.Nënveprimi						
2.2.Nënveprimi						
OBJEKTIVA SHITESË						

► Shtojca 3: Forma e raportimit vjetor mbi punën e fëmijëve

Raport mbi situatën e punës së fëmijëve në Kosovë: arritjet, sfidat, ndërhyrjet dhe planet

1. Situata e punës së fëmijëve:

- 1.1 Numri i rasteve të identifikuara sipas gjinisë dhe sektorëve.
- 1.2 Shtrirja gjeografike
- 1.3 Profili i fëmijëve të përfshirë në FRPF

2. Ndërhyrjet për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë.

- 2.1 Ndërhyrjet në nivel lokal
 - 2.1.1 Arritjet
 - 2.1.2 Sfidat
 - 2.1.3 Planet
- 2.2 Ndërhyrjet në nivel qendror
 - 2.2.1 Arritjet
 - 2.2.2 Sfidat
 - 2.2.3 Planet

3. Rekomandimet për autoritetet komunale dhe qendrore

► Shtojca 4: Treguesit e punës së fëmijëve

Korniza e treguesve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të komponentës Mbrojtja sociale, përcakton dy tregues specifik për punën e fëmijëve:

Treguesi 4: Numri i fëmijëve të identifikuar të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme⁵, dhe

Treguesi 5: Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në punë⁶

Qëllimet e Qëndrueshme Zhvillimore (Sustainable Development Goals), trajtojnë punën e fëmijëve në kuadër të:

- Qëllimi 8: Promovimi i rritjes përfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësimi i plotë produktiv dhe punë e denjë për të gjithë,
- Caku 8.7: Masa të menjëhershme dhe efektive për zhdukjen e punës së detyruar, skllavërisë moderne dhe trafikimit me qenie njerëzore dhe ndalimi e eliminimi i formave më të këqija të punës së fëmijëve, përfshirë rekrutimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve ushtarë, dhe deri me 2025 të ndërpritet puna e fëmijëve në të gjitha format e saj.
- Treguesi 8.7.1: Proporcioni dhe numri i fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas gjinisë dhe moshës⁷.

Definimi:

Korniza e treguesve për mbrojtjen e fëmijëve (Ligji për Mbrojtjen e fëmijëve)

Puna e fëmijëve është punë e cila me natyrën ose mënyrën se si zhvillohet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon fëmijës të drejtën për arsim.

Aspektet kryesore që mund të dëmtojnë fëmijën përfshijnë: a) orët e gjata në punë, b) ngacmimet fizike, morale dhe psikologjike që i shkaktohen fëmijës, c) pamundësia për të ndjekur shkollën dhe për të gëzuar të drejtën për rekreacion.

Format e Rrezikshme të Punës së Fëmijës - janë llojet e punës që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime (shpeshherë permanente) apo sëmundje (shpeshherë permanente) të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës;

Të përcaktuara në UA QRK 05/2013

5 Burimi i të dhënave- MPMS; frekuenca e publikimeve: llogaritja vjetore të bazuara në të dhënat administrative

6 Burimet e të dhënave- Anketat e ekonomive familjare, siç janë MICS dhe DHS, me modulën e veçantë për punën e fëmijëve; frekuenca e publikimeve: 3-5 vjet

7 Burimet e të dhënave: anketat e ekonomive familjare si Anketat e Fuqisë Punëtore, MICS (mbështetur nga UNICEF), Anketat Demografike dhe Shëndetësore (mbështetur nga ILO), Programi i Informatave Statistikore dhe Monitorimit- SIMPOC (mbështetur nga ILO), Hulumtimet e BB për Kushtet e Jetesës.

Megjithatë, për nevoja të monitorimit të situatës së punës së fëmijëve dhe nivelit të reagimit, si bazë për politikëbërje dhe ndërmarrje të intervenimeve efektive për mbrojtje nga puna e fëmijëve, mbledhja dhe analiza e të dhënave nga MPMS duhet të përfshijë:

- ▶ Nivelin e reagimit të institucioneve për identifikim dhe referim të rasteve, respektivisht numri i rasteve të identifikuara/referuara nga secili institucion që duhet të kontribuoj në këtë drejtim (shkollat, QMF-të, spitalet rajonale, QKUK, policia, inspektoriatet, ...)
- o në nivel vendi
- o në secilën komunë
- ▶ Numrin e fëmijëve të përfshirë në punë të fëmijëve, të ndarë sipas:
 - o Gjinisë
 - o Moshës
 - o Përkatësisë etnike
 - o Sektorit
 - Punë në rrugë (shitje të gjësendeve të imta, bartje/transportim i mallrave me karrocë, kërkim lëmoshe, ...)
 - Bujqësi
 - Pylltari
 - Ndërtimtari
 - Reciklim (puna në deponi të mbeturinave apo mbledhja e mbeturinave në kontenjerë)
 - Exploatim i pasurive natyrore (gërmime sipërfaqësore të rërës, gurëve, thëngjillit)
 - Tjetër (që nuk është në Listën e FRrPF)
 - Punë shtëpiake⁸
 - o Rreziqet të cilave u ekspozohet fëmija:
 - Rreziqet nga mjedisi i punës:
 - Ekspozimi ndaj temperaturave të ulëta apo të larta, ndaj zhurmës dhe dridhjes;
 - Ekspozimi ndaj rreziqeve të trafikut;
 - Ekspozimi potencial ndaj dhunës dhe keqtrajtimit;
 - Ekspozimi ndaj kushteve të dobëta higjienike, shembjeve të dheut, apo rreziqeve tjera;
 - Ekspozimi ndaj substancave toksike dhe/apo biologjike;
 - Ekspozimi ndaj radioaktivitetit;
 - Ekspozimi ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave.
 - Rreziqet nga mjetet e punës:
 - Operimi me mjete të mprehta, pajisje tjera të rrezikshme apo me makineri bujqësore.
 - Rreziqet nga aktivitetet punuese:
 - Bartja e peshave të rënda;
 - Puna në lartësi (mbi dy metra);
 - Pozita e papërshtatshme e punës (qëndrimi kërrusur për periudha të gjata kohore);
 - Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura.
 - Rreziqet nga kohëzgjatja/orari i punës:
 - Interferimi i orarit të punës me vijimin e rregullt të shkollës;
 - Puna natën (ndërmjet orës 20.00-06.00);
 - Angazhimi i fëmijëve të moshës 5-11 vjeçare në aktivitet ekonomik 1 orë në javë, apo në punë shtëpiake mbi 21 orë në javë;

⁸ Si referencë për të dalluar këtë formë të punës së fëmijëve nga ndihma që pritet të ofrohet nga secili fëmijë si pjesë e përgjegjësisë familjare mund të shfrytëzohet koha e angazhimit të fëmijës:

- Angazhimi i fëmijëve të moshës 5-11 vjeçare në punë shtëpiake mbi 21 orë në javë;
- Angazhimi i fëmijëve të moshës 12-14 vjeçare në punë shtëpiake mbi 21 orë në javë;
- Angazhimi i fëmijëve të moshës 15-17 vjeçare në aktivitet ekonomik mbi 43 orë në javë

- Angazhimi i fëmijëve të moshës 12-14 vjecare në aktivitet ekonomik për së paku 14 orë në javë, apo në punë shtëpiake mbi 21 orë në javë;
- Angazhimi i fëmijëve të moshës 15-17 vjecare në aktivitet ekonomik mbi 43 orë në javë.
- o Vijueshmërisë së shkollës (braktisje, kombinim i punës dhe shkollës)
- o Shpërndarjes gjeografike (urban/rural, sipas komunave)
- ▶ Shkaqet e punës së fëmijëve
 - o Në nivel vendi
 - o Në nivel të komunave
- ▶ Nevojat e fëmijëve të identifikuar në forma të rrezikshme të punës dhe familjeve të tyre (faktorët mbrojtjes)
 - o në nivel vendi
 - o në secilën komunë
- ▶ Niveli i reagimit të institucioneve për mbrojtjen dhe tërheqjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës:
 - o në nivel vendi
 - o në secilën komunë

Intervenimet e nevojshme në bazën e të dhënave të shërbimeve sociale, për kategorinë Puna e Rrezikshme e Fëmijëve

- ▶ Me qëllim të gjenerimit të raporteve të plota vjetore, përfshirë të gjitha aspektet e listuara më lartë, nevojiten rishikimet/plotësimet e meposhtme:
 - o Të përcaktohet edhe institucioni/organizata/pala që ka referuar rastin
 - o Shërbimet: 'reintegrimi ekonomik' të zëvendësohet me 'fuqizimi ekonomik i familjes'; këtu do të raportoheshin shërbimet si mbështetja e prindërve apo anëtarëve të rritur të familjes (që jetojnë me fëmijën) përmes masave aktive të punësimit, të cilat kanë për qëllim rritjen e kapacitetit të familjes për gjenerim të të hyrave.
 - o Fomat e ndaluara të punës, të zëvendësohen me 'Listën e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve' (shih më lartë).
 - o Të përcaktohet edhe lokacioni i punës (opcionet: urban/rural)
 - o Të përcaktohet edhe vijueshmëria e shkollës (opcionet: braktisje e shkollës/ kombinim i punës dhe shkollës)
 - o Të përcaktohen edhe shkaqet e punës së fëmijëve
 - o Të përcaktohen edhe nevojat e fëmijëve të identifikuar në punë
 - o Të përcaktohen edhe institucionet e përfshira në ofrimin e shërbimeve

